

2.2. SUNDIMI I LIGJIT DHE TË DREJTAT THEMELORE

2.2.1. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Funksionimi i gjyqësorit

Dokumentet strategjike

Është miratuar një Strategji e re Ndërsektoriale për Drejtësinë për vitet 2024-2030, por zbatimi i saj duhet të përmirësohet ende. Cilësia e strategjisë dhe monitorimi i saj janë përgjithësisht të kënaqshme. Cilësia dhe shpejtësia (afatet kohore) e raportimit janë përmirësuar. Megjithatë, cilësia e të dhënave statistikore mbetet e dobët.

Organet e menaxhimit

Efienca e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) në emërimin, promovimin, transferimin dhe vlerësimin e magjistratëve mbetet shumë e ulët, gjë që ndikon në cilësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet. KLGJ finalizoi 41 raporte vlerësimi dhe KLP 40. KLGJ dhe KLP duhet të vazhdojnë reduktimin e stokut të raporteve të pambaruar të vlerësimit dhe të përmirësojnë cilësinë e raporteve, si dhe të miratojnë dhe zbatojnë çdo vit një plan vlerësimi. Ende mungojnë rregulla të rëndësishme funksionimi, dhe bashkërendimi i përgjithshëm ka nevojë ende për t'u forcuar.

Reforma në drejtësi e vitit 2016 ka forcuar pavarësinë e Këshillave. Megjithatë, mangësitë e konstatuara më parë vazhdojnë të mbeten në lidhje me emërimin e anëtarëve jo-magjistratë në KLGJ dhe KLP. Ata nuk i nënshtrohen të njëjtave standarde si anëtarët magjistratë për verifikimin e figurës dhe të pasurisë, gjë që ndikon në transparencën dhe meritokracinë e procesit. KLP dhe KLGJ duhet të forcojnë më tej mbikëqyrjen etike ndaj anëtarëve të tyre në praktikë. KLGJ ka miratuar rregulla specifike të procedurës që rregullojnë konfliktin e interesit të anëtarëve të saj. KLGJ ka nxjerrë rregullore për afatet minimale të shqyrtimit gjyqësor dhe standardet sasiore, si dhe modele standarde për vendimet gjyqësore.

Komunikimi strategjik mbetet i dobët. Rregullat e procedurës për të garantuar transparencën në lidhje me promovimet (ngritjet në detyrë), emërimet dhe transferimet, duke përfshirë vlerësimet, janë miratuar nga KLGJ dhe zbatimi i tyre duhet të sigurohet më tej. KLP ka miratuar rregullore për mentorimin e kandidatëve magjistratë-prokurorë. Është gjithashtu e rëndësishme të rregullohet emërimi i kryetarëve të gjykatave. KLGJ dhe KLP duhet të adresojnë urgjentisht mungesën e burimeve të specializuara, veçanërisht magjistratëve të komanduar (të deleguar) dhe stafit të nevojshëm për të kryer hartimin e raporteve të vlerësimit, në përputhje me standardet e larta të vettingut. Këshillat kanë mungesë të strukturave të brendshme dhe stafit për të trajnuar personelin jo-magjistrat në gjykata dhe prokurori, siç parashikohet me ligj.

Pavarësia dhe paanshmëria

Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit është e kënaqshme në gjykatat e niveleve më të larta dhe në gjykatat e shkallës së parë. Ndërsa qëndrueshmëria e gjyqësorit është përmirësuar, përpjekjet e zyrtarëve publikë ose politikanëve për të ushtruar ndikim dhe presion të panevojshëm janë shtuar, duke ngritur shqetësime serioze, veçanërisht reagimet publike të paprecedentë dhe përpjekjet për të ushtruar presion nga ekzekutivi dhe legjislativi kundër Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD). 7 magjistratë u vendosën nën mbrojtje. Institucionet vetëqeverisëse janë shprehur publikisht kundër presionit politik mbi gjyqësorin, duke dhënë deklarata publike.

Shqipëria duhet të sigurojë një procedurë konkurruese dhe me standard të lartë për vlerësimin dhe emërimin e Kryeprokurorit të Posaçëm pranë Prokurorisë së Posaçme, në përputhje me parimet më të larta të meritës

dhe pavarësisë. Ndërsa procesi i emërimit të Drejtorit të ri të Byrosë Kombëtare të Hetimit ka qenë deri tani i hapur dhe konkurrues, ka pasur vonesa në emërimin përfundimtar dhe KLP duhet të miratojë rregulla dhe procedura të qarta për rastet e ardhshme. Pasiguria juridike mbeti sa i përket përfundimit të mandatit të dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si pasojë e interpretimeve të ndryshme të dispozitave përkatëse nga Parlamenti dhe Gjykata e Lartë, respektivisht.

Pavarësisht garancive të forta ligjore, emërimet dhe zhvillimi i karrierës bazuar në meritë dobësohen në praktikë nga ritmi i ngadaltë i vlerësimeve cilësore nga KLP dhe KLGJ për magistratët dhe përdorimi i vazhdueshëm i transferimeve si alternativë ndaj promovimeve të bazuara në meritë.

Përgjegjshmëria

Llogaridhënia e gjyqësorit është në përgjithësi e kënaqshme. Rivlerësimi gjithëpërfshirës kalimtar (vetingu) i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, funksionimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe progresi i vazhdueshëm në zbatimin e reformës në drejtësi kanë forcuar llogaridhënien. Përpjekjet për të parandaluar korrupsionin pas verifikimit duhet të rriten në të gjithë sistemin gjyqësor. Këshillat dhe ILD miratuan një rregullore të përbashkët për rastet e sjelljes “jo etike” të magistratëve. Këshillat kanë miratuar gjithashtu aktet rregullatore për të bërë kontrolle të “pasurive dhe të së kaluarës” për rastet e mbetura të verifikimit të shkallës së parë.

Procesi i vettingut ka përparuar më tej dhe është pranë finalizimit. Dhoma e Apelit ka rritur ritmin e shqyrtimit të ankesave dhe aktualisht është në rrugë drejt përmbushjes së afatit kushtetues deri në qershor 2026. Deri më 1 tetor 2025, vendimet përfundimtare kanë rezultuar në 426 largime dhe shkarkime (52,9% të rasteve), dhe 321 konfirmime në detyrë (39,9% të rasteve). 53 ankime mbeten të paadresuara. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) vazhdoi mbikëqyrjen e procesit. ONM ka lëshuar 42 rekomandime për ankime dhe tetë mendime kundërshtuese ndaj vendimeve të Dhomës së Apelit.

Sfida qëndrojnë në atraktivitetin e pozicionit të inspektor-magjistrat pranë ILD-së dhe ende priten ndryshime ligjore për ta adresuar këtë çështje. ILD duhet të forcojë protokollet e inspektimeve për të trajtuar rastet e korrupsionit brenda sistemit gjyqësor. Inspektimet tematike mbeten prioritet, përfshirë një plan për koordinimin me të gjitha institucionet përkatëse mbi veprimet pasuese. ILD, KLGJ, KLP dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) duhet të përditësojnë procedurat e tyre të brendshme dhe të sigurojnë staf dhe burime të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e kontrolleve të integritetit mbi magistratët dhe kandidatëve për magistratë, në përputhje me standardet e larta të vettingut.

Cilësia e drejtësisë

Cilësia e drejtësisë duhet të përmirësohet. Nevojiten ende masa për të adresuar çështjet e raportuara më parë, duke përfshirë:

- i. cilësinë e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm;
- ii. qëndrueshmërinë e jurisprudencës;
- iii. numrin e lartë të vendeve të lira të punës në gjyqësor dhe sasinë e pamjaftueshme të stafit të gjykatave;
- iv. mungesën e një sistemi modern të integruar elektronik të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe prokurori;
- v. cilësinë, qëndrueshmërinë dhe publikimin në kohë të vendimeve gjyqësore;
- vi. cilësinë e infrastrukturës së gjykatave; dhe
- vii. besueshmërinë e të dhënave statistikore.

Përmirësime të mëtejshme në sistemin e trajnimit gjyqësor janë ende të domosdoshme, përfshirë një rishikim të plotë të provimit të pranimit, pavarësisht ndryshimeve të kufizuara të bëra nga Shkolla e Magjistraturës. Rishikimi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm duhet të përfundojë për të adresuar kufizimet e cilësisë dhe nevojat e ngutshme të sistemit gjyqësor. Legjislacioni ka nevojë dhe duhet të miratohet për të ndaluar magjistratët e përjashtuar nga vettingu ose ata me ndalim 15-vjeçar nga pozicione të larta gjyqësore të marrin pozicione si staf trajnimi në Shkollën e Magjistraturës. Standarde të përbashkëta për konsolidimin e hartimit të vendimeve gjyqësore duhet ende të miratohen dhe zbatohen.

Cilësia gjyqësore pengohet (dëmtohet) seriozisht nga mungesa e progresit në emërimin e kryetarëve të gjykatave në të gjitha nivelet dhe nga numri i pamjaftueshëm i stafit gjyqësor, veçanërisht i asistentëve ligjorë. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka emëruar 42 gjyqtarë të rinj në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Megjithatë, vendet vakante në Gjykatën e Apelit mbeten dhe duhet të plotësohen me prioritet të lartë. Kuotat e përcaktuara nga KLGJ dhe KLP për Shkollën e Magjistraturës për klasën 2025–2028 janë një çështje shtesë shqetësuese, pasi janë kryesisht të pamjaftueshme për të siguruar që në afatin mesatar, nevojat e sistemit të trajtohen gradualisht. Rritja e numrit dhe cilësisë së kandidatëve për magjistratë dhe asistentëve ligjorë të pranuar në Shkollën e Magjistraturës është thelbësore.

Ndërkohë që Qeveria i ka alokuar fondet e nevojshme për ambientet Gjykatës së Apelit, cilësia e infrastrukturës së gjykatës mbetet në përgjithësi e dobët. Kjo ka çuar në mbipopullim dhe në praktikën e vazhdueshme jo transparente të seancave dëgjimore që zhvillohen në dhomat e gjyqtarëve. Nuk është bërë përparim në sigurimin e standardeve të duhura të sigurisë për gjyqtarët dhe prokurorët. Vrasja me armë zjarri të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Tiranës gjatë një seance gjyqësore theksoi më tej shqetësimet në lidhje me papërshtatshmërinë e infrastrukturës së gjykatës, të cilat i bëjnë gjyqtarët dhe prokurorët të cënueshëm ndaj sulmeve të drejtpërdrejta personal, si dhe nënvizoi nevojën për masa që garantojnë sigurinë e magjistratëve. Në nivelin e SPAK-ut, ka hapësirë për transparencë dhe verifikim edhe më të madh të marrjes në pyetje, veçanërisht përmes dhomave të reja të marrjes në pyetje.

Duhet të merren hapa vendimtarë nga KLGJ dhe KLP për sigurimin e konsolidimit, publikimit, raportimit, qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë së të dhënave statistikore në gjithë sistemin gjyqësor, bazuar në një kuadër të koordinuar dhe të harmonizuar rregullator të zbatueshëm për të gjithë sistemin. KLGJ ka miratuar një kuadër rregullator për ngritjen e dhomave të specializuara, i cili duhet të zbatohet me efektivitet.

Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve mbetet e papërdorur në praktikë. Trajnimi për ndërmjetësuesit ka përparuar, duke përfshirë një fushatë publike të përmirësuar nga Dhoma e Ndërmjetësimit për të rritur ndërgjegjësimin dhe transparencën. Referimi për në ndërmjetësim mbetet i kufizuar. Përpjekjet për të dhënë informacion të konsoliduar mbi mundësinë e përdorimit të ndërmjetësimit dhe rritjen e cilësisë së shërbimit duhet të vazhdojnë më tej.

Efikasitet

Efikasiteti i sistemit të drejtësisë është i kufizuar. Efikasiteti vazhdon të pengohet nga kohëzgjatja e shtuar e procedurave dhe nga një numër i madh i çështjeve të prapambetura, veçanërisht në nivelin e apelit. Publikimi i vendimeve përfundimtare vazhdon të tejkalojë afatin ligjor, dhe vonesa serioze shkaktohen nga menaxhimi i pamjaftueshëm i seancave gjyqësore dhe mungesa e avokatëve mbrojtës. KLGJ ka miratuar një plan veprimi për efikasitet, por duhet të ndërmarrë hapa të mëtejshëm, duke përfshirë rishikimin e legjislacionit në përputhje me parimet e përgjithshme të reformës në drejtësi dhe standardet evropiane.

Edhe pse është alokuar buxheti i mjaftueshëm për të vendosur një sistem modern të integruar elektronik të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe prokurori, implementimi i plotë pritët të realizohet vetëm në vitin 2030. Kjo afat kohor është i dëmshme për cilësinë e përgjithshme të drejtësisë dhe duhet përshpejtuar.

Përpjekje të mëdha janë të nevojshme për të përmirësuar dixhitalizimin e sistemeve të drejtësisë. Një mjet elektronik komunikimi ndërmjet Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe avokatëve është pilotuar me sukses. Megjithatë, mungesa e financimeve për ta zgjeruar atë në të gjitha gjykatat, veçanërisht në Gjykatën e Apelit të Përgjithshëm, po kufizon potencialin e tij të plotë për të përmirësuar aksesin në drejtësi.

Lufta kundër korrupsionit

Rekordi i suksesit

Historiku i suksesit në luftën kundër korrupsionit është përmirësuar për çështjet e nivelit të lartë dhe është përkeqësuar pak për çështjet jo të nivelit të lartë.

Struktura e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK), e përbërë nga Zyra e Prokurorisë së Posaçme (ZPP), Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) dhe gjykatat kundër korrupsionit dhe krim të organizuar (gjykatat e SPAK-ut të shkallës së parë dhe apelit), ka konsoliduar më tej rezultatet e saj pozitive në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimet në çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë, përfshirë edhe ata që përfshijnë politikanë dhe zyrtarë të nivelit të lartë, si dhe çështjet që lidhen me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

Në vitin 2024, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsion dhe Krim të Organizuar (gjykata e apelit SPAK) dha 24 dënime përfundimtare me 106 persona të dënuar me vendime përfundimtare në çështjet e korrupsionit, duke përfshirë 13 dënime në çështje të nivelit të lartë. Gjykata e Posaçme për Korrupsion dhe Krim të Organizuar (gjykata SPAK e shkallës së parë) dënoi 93 persona në çështjet e korrupsionit. Kapaciteti i SPAK-ut në hetimet financiare është rritur dhe përdorimi sistematik i hetimeve financiare dhe konfiskimet e pasurive është përmirësuar vazhdimisht. Megjithatë, numri i referimeve të SPAK nga autoritete të tjera duhet të rritet dhe kapaciteti dhe organizimi i brendshëm i SPAK-ut për të përballuar ngarkesën në rritje të punës kërkon vëmendje. *(Shih edhe Kapitullin 24 – Drejtësia, liria dhe siguria)*

Korniza ligjore

Korniza ligjore për luftën kundër korrupsionit është përgjithësisht e vendosur, por ka nevojë të përmirësohet në lidhje me masat parandaluese. Janë ndërmarrë disa hapa për rishikimin e legjislacionit për konfliktin e interesit, megjithëse legjislacioni kundër korrupsionit mbetet kompleks dhe i paplotë. Legjislacioni i rishikuar për konfliktin e interesit, mbrojtjen e denoncuesve, financimin e partive politike, lobimin, donacionet dhe sponsorizimet, luftën kundër pastrimit të parave, kontrollin e brendshëm dhe inspektimin financiar ende duhet të miratohet. Ligji për policinë është rishikuar, por policia shtetërore mbetet shumë e prekshme ndaj korrupsionit.

Dokumentet strategjike

Dokumentet strategjike janë në vend dhe janë të përshtatshme. Shqipëria miratoi Strategjinë Kundër Korrupsionit për vitet 2024-2030, duke targetuar sektorë të ndjeshëm si prona, prokurimi publik, shëndetësia, arsimi, doganat dhe taksat, përfshirë qeverisjen vendore dhe sektorin privat. SPAK miratoi Strategjinë për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura 2025-2027, e cila kontribuon në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Strategjisë Kombëtare Kundër Krimit të Organizuar. Megjithatë, mbetet i nevojshëm forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale, i planifikimit, koordinimit dhe mekanizmave të monitorimit.

Korniza institucionale

Korniza institucionale për luftën kundër korrupsionit është funksionale. Masat e saj parandaluese ende duhet të përmirësohen, dhe problemet me aspektet e zbatimit të ligjit mbeten.

Që nga themelimi, SPAK ka dhënë rezultate pozitive në luftën kundër korrupsionit. Organe të tjera të ngarkuara me luftën kundër korrupsionit, veçanërisht Prokuroria e Përgjithshme dhe policia e shtetit, ende duhet të përmirësojnë rezultatet e tyre në luftën kundër korrupsionit.

Pavarësisht përpjekjeve, policia e shtetit mbetet shumë e ndjeshme ndaj korrupsionit. Vlerësimi kalimtar dhe periodik i oficerëve të policisë së shtetit ('vetingu i policisë') dhe procesi i verifikimit të integritetit kanë vazhduar, por ndikimi i tyre mbetet i kufizuar. Në vitin 2024, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore vazhdoi të marrë një numër të madh ankesash (mbi 5 000). Agjencia rekomandoi hetime disiplinore për 283 punonjës dhe referoi 463 punonjës të zbatimit të ligjit për ndjekje penale. Pas dorëheqjes së Drejtorit të Përgjithshëm në korrik, procedura e emërimit të Drejtorit të ri të Agjencisë duhet të kryhet në përputhje me parimet më të larta të meritës, konkurrencës dhe transparencës. Duhet të zbatohen më tej masa për përmirësimin e llogaridhënies, pavarësisë dhe integritetit të policisë shtetërore shqiptare.

Korniza institucionale për parandalimin e korrupsionit vazhdon të ketë një ndikim të kufizuar, përfshirë në sektorët vulnerabël, dhe koordinimi i zbatimit të ligjit mbetet i dobët. Pozicioni i Ministrit të Shtetit për Antikorrupsion dhe Administratë Publike është ruajtur në ekzekutivin e ri. Stafi i Drejtorisë së Përgjithshme për Antikorrupsion (DPAK) është ende i kufizuar në rreth 30 punonjës, të mbështetur nga koordinаторët antikorrupsion të vendosur në rreth 20 institucione, duke kufizuar kapacitetet për të mbikëqyrur në mënyrë efektive zbatimin dhe vlerësimin e masave parandaluese, së bashku me vlerësimet e thella të riskut.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konflikeve të Interesit (ILDKPKI) ka vazhduar realizimin e mandatit të tij. Nevojitet rritje e efektivitetit dhe transparencës në verifikimet e deklaratave të pasurive dhe interesave nga ILDKPKI, duke përfshirë profilizimin me risk të lartë. Deklaratat e pasurive duhet të publikohen online, në përputhje me kërkesat ligjore. Koordinimi me organet e zbatimit të ligjit duhet të përmirësohet më tej. ILDKPKI prezantoi një funksionalitet kërkimi për të përmirësuar aksesin në të dhëna, por ende me kërkesë, dhe ka nënshkruar një memorandum me Njësinë e Hetimit Financiar.

Në vitin e kaluar, ILDKPKI ka marrë 182 raporte nga autoritetet publike dhe 258 nga bizneset. Në të njëjtën kohë, numri i rasteve të denoncimit të sinjalizuesve (whistleblowing) mbeti i ulët – ILDKPKI shqyrtoi 6 raporte të reja denoncuesish në vitin 2024.

Ndërgjegjësimi i zyrtarëve publikë për standardet etike dhe zbatimin e tyre duhet të përmirësohet. Cilësia dhe zbatimi i planeve të integritetit, të harutara në nivelet qendrore dhe vendore, mbeten ende të dobëta.

Në mars të vitit 2025, Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO) i Këshillit të Evropës përfundoi procedurën e raundit të pestë të përputhshmërisë për Shqipërinë, duke konstatuar se 18 nga 24 rekomandimet ishin adresuar në mënyrë të kënaqshme. Shqipëria ende duhet të sigurojë që rregullat mbi kufizimet pas punësimit të aplikohen si për anëtarët e Këshillit të Ministrave, ashtu edhe për këshilltarët politikë. Gjithashtu, legjislacioni mbi kontaktet me lobistët duhet të miratohet dhe zbatimi i rregullave për parandalimin e konflikteve të interesit që aplikohen për Këshillin e Ministrave duhet të demonstrohet.

Të drejtat themelore

Korniza e përgjithshme

Korniza e përgjithshme për të drejtat themelore ka nevojë për përmirësim. Zbatimi dhe respektimi i të drejtave themelore duhet të përmirësohen.

Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Bashkëpunimi me organet ndërkombëtare të monitorimit të të drejtave të njeriut është i kënaqshëm, por ndjekja e rekomandimeve të tyre duhet të përmirësohet. Shqipëria është palë në instrumentet kryesore

ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Megjithatë, ende nuk ka nënshkruar Protokollin Opsional të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Shqipëria duhet të zhvillojë një sistem gjithëpërfshirës monitorimi dhe mbledhjeje të të dhënave për të vlerësuar nivelin e zbatimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive për të drejtat e njeriut. Shqipëria përfundoi rishikimin e saj të katërt periodik universal, duke mbështetur 239 nga 253 rekomandimet e marra. Shqipëria vazhdoi të përfitojë nga statusi i saj i vëzhguesit në Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA).

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)

Shqipëria vazhdon të sigurojë bashkëpunim të mirë me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Gjatë periudhës së raportimit, Gjykata gjeti shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që lidhen kryesisht me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të drejtën për lirinë dhe sigurinë. Shqipëria përballet me sfida në zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së. Më 1 janar 2025, Shqipëria kishte 25 vendime kryesore të GJEDNJ-së në pritje për zbatim. Aktualisht, 10 raste janë nën mbikëqyrje të përforcuar nga Këshilli i Ministrave (krahasuar me 16 në vitin 2024). Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin e këtyre vendimeve, veçanërisht në rastin *Strazimiri kundër Shqipërisë*, që ka të bëjë me trajtimin çnjerëzor dhe degradues të pacientëve forenzikë psikiatrikë dhe të burgosurve me çrregullime mendore. Gjithashtu, Shqipëria ende duhet të sqarojë mjetet juridike ekzistuese për të adresuar shpronësimet e paligjshme dhe shembjen e pronave në rastin *Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*.

Promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut

Korniza ligjore dhe institucionale për promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut është e paplotë dhe ka nevojë të përmirësohet. Promovimi dhe zbatimi efektiv i të drejtave të njeriut është sfidues, veçanërisht në lidhje me të drejtën e pronës dhe të drejtat e fëmijëve. Avokati i Popullit (Ombudsperson) ka vazhduar të ushtrojë mandatin e tij në mënyrë të kënaqshme. Që nga viti 2014, ai është akredituar në nivel global si një Institucion Kombëtar për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ) me status A.

Parlamenti ende nuk ka rizgjedhur një Avokat të Popullit dhe një Komisioner kundër Diskriminimit, pasi mandatet e drejtuesve aktualë të këtyre institucioneve kanë përfunduar përkatësisht në vitet 2022 dhe 2023, gjë që rrezikon të dobësojë seriozisht legjitimitetin e këtyre institucioneve të pavarura. Mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare vazhdon, duke ndikuar në funksionimin e zyrave rajonale të të dy institucioneve. Në përgjithësi, numri më i madh i ankesave të pranuar nga Avokati i Popullit në vitin 2024 kishte të bënte me kufizimin e lirive personale (295 ankesa, 16% në total). Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbetet përgjithësisht i ulët, duke penguar efektivitetin e mbikëqyrjes dhe duke vështirësuar kompensimin për shkeljet e të drejtave të njeriut.

Parandalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor

Shqipëria siguron garanci ligjore të mjaftueshme për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor, dhe ndjekja e rasteve është e përshtatshme. Shqipëria në përgjithësi përmbush detyrimet e saj për ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor. Funksionimi i Mekanizmit Kombëtar Parandalues mbeti i kënaqshëm; megjithatë, ndjekja e rekomandimeve të tij është e ulët. Plani i veprimit i Shqipërisë për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtërues (CPT) duhet të zbatohet. Nuk janë ndërmarrë hapa për të adresuar shqetësimet serioze në lidhje me kushtet për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor dhe pacientët forenzikë. Mbipopullimi, mungesa e stafit mjekësor dhe terapeutik, si dhe ambientet e papërshtatshme mbeten shqetësime serioze.

Zbatimi i sanksioneve penale

Sistemi për ekzekutimin e sanksioneve penale (përfshirë lirimin me kusht) ka nevojë për përmirësim. Korrupsioni, kujdesi shëndetësor i dobët dhe mungesa e stafit në sistemin penitenciar dhe në qendrat e paraburgimit mbeten shqetësuese. Ndërsa mbipopullimi mbetet një sfidë, shkalla e zënies së vendeve ka treguar një rënie të qëndrueshme vjetore, gjë që tregon përparim gradual drejt lehtësimit të presionit në kapacitet. Shërbimi i provës është funksional. Megjithatë, duhet përmirësuar parandalimi dhe rehabilitimi. Përdorimi i monitorimit elektronik është pezulluar që nga viti 2017 dhe duhet të rikthehet urgjentisht. Duhet kushtuar vëmendje e veçantë deradikalizimit të të burgosurve.

Mbrojtja e të dhënave personale

Korniza ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale është e përshtatshme, por kapacitetet e Agjencisë së Mbrojtjes së të Dhënave ende duhet të përmirësohen. Një përparim i mirë u arrit me miratimin e Ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale në dhjetor 2024, i cili është në përputhje të plotë me acquis-in e BE-së. Shtatë nga dhjetë aktet nënligjore janë miratuar. Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin efektiv, duke përfshirë kapacitetin administrativ dhe buxhetor. Nevoja për veprime të mëtejshme është e domosdoshme për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe kapacitetin parandalues të institucioneve publike. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave konsultohet sistematikisht mbi projektligjet që mund të ndikojnë në të dhënat personale, dhe rekomandimet e tij ndiqen gjerësisht nga kontrolluesit dhe përpunuesit e dhënave në sektorin publik dhe privat.

Liria e fesë ose besimit

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë në përgjithësi respektohet në Shqipëri. Kthimi i pronave që i përkasin grupeve fetare dhe që u janë shpronësuar gjatë periudhës komuniste mbetet një çështje e pazgjidhur. Varësia e disa grupeve fetare nga mbështetja financiare e palëve të treta krijon dobësi dhe rreziqe për këto grupe.

Liria e shprehjes

Intimidimi i gazetarëve

Kuadri ligjor për mbrojtjen e gazetarëve është në fuqi, por sulmet verbale dhe fizike, fushatat denigruese dhe paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) ndaj gazetarëve kanë vazhduar.

Organizatat për lirinë e medias kanë raportuar 45 raste të shkeljeve të sigurisë së gazetarëve në vitin 2024 (nga 46 raste në vitin 2023). Rastet e frikësimit dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, përfshirë ato nga zyrtarë të lartë shtetërorë dhe oficerë policie, janë bërë më të theksuara, veçanërisht ndaj gazetarëve investigativë dhe grave gazetare, përmes fushatave të njollosjes, sulmeve fizike dhe verbale me motive politike dhe dezinformimit.

Në tetor 2024, Prokuroria e Përgjithshme emëroi një këshilltar për median si person kontakti për raportimin dhe ndjekjen e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias. Një pikë kontakti për sigurinë e gazetarëve u krijua gjithashtu në Ministrinë e Brendshme dhe në Policinë e Shtetit. Pandëshkueshmëria mbeti problem për shkak të mungesës së një praktike të qëndrueshme hetimesh dhe ndjekjeje gjyqësore. Në prill 2025, Gjykata Kushtetuese mori një vendim në favor të një gazetari, duke shfuqizuar njëzëri vendimet gjyqësore të mëparshme që kishin autorizuar sekuestrimin nga Prokuroria e Posaçme (SPAK) të pajisjeve elektronike, të dhënave dhe materialeve të gazetarit, me arsyetimin se sekuestrimi përbënte një ndërhyrje joproporcionale në të drejtën për të mbrojtur konfidencialitetin e burimeve gazetareske.

U ngritën shqetësime për ligjshmërinë dhe respektimin e procesit të rregullt ligjor lidhur me veprimet e autoriteteve që parandaluan qasjen e gazetarëve nga katër media në ambientet që ata përdornin. Në gusht 2025, një gjykatë e shkallës së parë konstatoi se masat kufizuese ndaj gazetarëve gjatë nxjerrjes së një konsorciumi mediatik nga godinat shtetërore ishin joproporcionale dhe në kundërshtim me detyrimet kushtetuese dhe me nenin 10 të KEDNJ-së mbi lirinë e shprehjes. Gjykata nuk hyri në thelbin e mosmarrëveshjes mbi pronësinë, por urdhëroi kthimin e pajisjeve dhe dokumenteve tek gazetarët.

Numri i kërcënimeve digjitale, ngacmimeve online dhe fushatave denigruese është rritur.

Shkeljet e privatësisë përbëjnë një tjetër shqetësim serioz, pasi të dhënat personale dhe profesionale të gazetarëve shpesh keqpërdoren nga subjekte të paautorizuara. Kjo situatë rëndohet nga mungesa e mekanizmave institucionalë efektivë për raportimin, trajtimin dhe parandalimin e këtyre kërcënimeve digjitale. Ende mungon monitorimi sistematik dhe raportimi mbi rastet gjyqësore që përfshijnë gazetarë. Gazetarët kanë akses të kufizuar në ndihmë juridike dhe mbështetje të pamjaftueshme nga vetë redaksitë dhe institucionet mediatike.

Kuadri legjislativ

Shqipëria nuk ka bërë përparim në përputhjen e kuadrit ligjor me acquis të BE-së dhe me standardet evropiane.

Kjo përfshin mungesën e progresit në adresimin e sfidave kryesore që pengojnë pavarësinë e mediave. Përqendrimi i lartë i tregut dhe mungesa e transparencës në pronësinë e mediave, në burimet e financimit dhe interesat ekonomike, përfshirë fondet publike, vazhduan të ndikojnë negativisht në pavarësinë dhe pluralizmin mediatik. Fyerja mbetet një vepër penale, e dënueshme me gjoja penale. Kodi Penal ende nuk parashikon mbrojtje të posaçme për gazetarët ndaj dhunës, sulmeve apo kërcënimeve gjatë ushtrimit të profesionit.

Po ashtu, kuadri ligjor nuk ofron garanci kundër padive strategjike ndaj pjesëmarrjes publike (SLAPP). Në janar 2025, u nis një dialog i strukturuar ndërmjet institucioneve shqiptare dhe aktorëve të medias, me synim diskutimin e reformave kyçe ligjore dhe rregullatore për forcimin e lirisë së shprehjes, përfshirë lirinë dhe pluralizmin e medias. Pas paraqitjes së rekomandimeve specifike në qershor 2025, puna e platformës vijon ende. Mbetet thelbësore konsultimi me Komisionin e Venecias për ndryshimet ligjore që do të rezultojnë nga ky proces, para miratimit të tyre. Ligji për të drejtën e informimit është gjerësisht i përafruar me standardet evropiane; megjithatë, duhen përcaktuar afate më të shkurtra dhe detyruese për përgjigjet ndaj kërkesave të gazetarëve, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

Zbatimi i legjislationit dhe funksionimi i institucioneve

Pavarësia e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) ende nuk është e garantuar, pasi vazhdon të ekzistojë mundësia e ndikimit politik dhe ekonomik në procedurat e emërimit të anëtarëve të bordit të AMA-s. Gjithashtu, janë vërejtur mangësi në zbatimin e Kodit të Transmetimit ndaj mediave që transmetojnë përmbajtje politike të regjistruar paraprakisht gjatë fushatave zgjedhore.

Komisioni ad hoc parlamentar për luftën kundër dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja ka hartuar Strategjinë e parë Kombëtare kundër Ndërhyrjes së Huaj dhe Dezinformimit, e miratuar nga Kuvendi në korrik 2025. Në zbatimin e saj, është thelbësore që strategjia të garantojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të sigurojë mbrojtjen e lirisë së shprehjes, të lirisë dhe pluralizmit të medias, në përputhje me acquis të BE-së dhe praktikën më të mira evropiane.

Zbatimi i Ligjit për të Drejtën e Informimit Publik mbetet i dobët. Autoritetet publike vazhdojnë praktikën e mosdhënies së informacionit, duke iu referuar në mënyrë të përgjithshme “interesi publik”, i cili ende nuk ka një përcaktim të qartë. Në vitin 2024, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka marrë 365 ankesa nga gazetarë, që lidhen me refuzimin për të siguruar informacion dhe

dokumente zyrtare. Nga këto raste, 283 janë zgjidhur përmes dhënies së informacionit të kërkuar gjatë procesit të shqyrtimit administrative.

Transmetuesi publik

Parregullsitë procedurale në procesin e zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të transmetuesit publik Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) në janar 2025 e kanë minuar më tej parimin e përzgjedhjes mbi bazën e meritës dhe kanë rritur shqetësimet lidhur me pavarësinë e RTSH-së.

Në shkurt 2025, Kuvendi i Shqipërisë shkarkoi të gjithë Këshillin Drejtues të RTSH-së, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, i cili lejon vetëm shkarkimin individual të anëtarëve të Këshillit Drejtues me respektim të garancive të procesit të rregullt ligjor. Emërimi i disa anëtarëve të Këshillit të ri, i ngritur në mars 2025, ngriti shqetësime për shkak të sfondit të tyre politik. Në prill 2025, bordi i ri zgjodhi Drejtorin e Përgjithshëm të RTSH-së.

Faktorët ekonomikë

Përqendrimi i lartë i pronësisë dhe praktikat netransparente të financimit vazhdojnë të kompromentojnë pavarësinë dhe pluralizmin e medias. Në prill 2024, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) filloi të publikojë në faqen e saj të internetit informacion të përmbledhur mbi strukturat e pronësisë dhe pronarët përfitues të mediave audiovizive me licencë.

Megjithatë, kjo faqe nuk përfshin të dhëna mbi interesat e ndërlidhura të pronarëve, konfliktet e interesit, apo ndikimet e mundshme mbi pronarët e medias ose persona të lidhur me ta. Kuadri ligjor ende nuk përmban dispozita për të rregulluar shpërndarjen e subvencioneve të tërthorta apo të reklamave shtetërore ndaj mediave, si dhe për të zgjeruar kërkesat për transparencë edhe për mediat online. Shqipëria ka ndërmarrë një hap fillestar drejt krijimit të një sistemi transparent të matjes së audiencës, i cili është thelbësor për të siguruar përgjegjshmëri në përdorimin e reklamave publike. Shqetësime të vazhdueshme lidhen me ndikimin e grupeve të biznesit të lidhura politikisht, veçanërisht gjatë periudhave parazgjedhore.

Internet

Në mars 2025, qeveria vendosi pezullimin e aksesit në një platformë të madhe të mediave sociale në të gjithë vendin për një periudhë 12-mujore, me arsyetimin e mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme. Megjithëse nuk pati një njoftim zyrtar për heqjen e ndalimit, platforma aktualisht është e aksesueshme në të gjithë territorin, pas një marrëveshjeje që synon garantimin e filtrave për gjuhën e urrejtjes në gjuhën shqipe. Kapacitetet e sigurisë kibernetike të mediave janë përgjithësisht të dobëta. Gjatë periudhës së raportimit janë regjistruar disa sulme kibernetike ndaj mediave

Organizatat profesionale dhe kushtet e punës

Vetërregullimi në sektorin e medias mbeti i dobët dhe u pengua nga mungesa e burimeve, polarizimi i peizazhit mediatik dhe përdorimi i vazhdueshëm i retorikës nxitëse në debatin publik.

Mbetet e rëndësishme të sigurohet mbështetje për nismat e vetërregullimit dhe të promovohet zbatimi i kodeve etike në të gjithë sektorin.

Siguria e kufizuar në punë dhe kushtet e dobëta të punës për gazetarët, të kombinuara me vetëcensurën dhe presionin nga aktorë politikë dhe pronarë mediash, vazhduan të paraqesin sfida serioze për gazetarët. Vijnë problemet me mospagimin e pagave, ngarkesat e tepërta të punës dhe pasigurinë në punë, veçanërisht në mediat lokale dhe ato online. Organizatat për lirinë e medias raportuan të paktën 13 ankesa zyrtare të reja pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës ndërmjet shtatorit 2024 dhe marsit 2025. Vetëcensura mbetet e përhapur, e nxitur nga presioni politik, kërcënimet ligjore dhe varësia ekonomike

Liria e tubimit dhe e shoqërimit

Liria e tubimit dhe e shoqërimit garantohet nga Kushtetuta dhe vazhdon të respektohet në mënyrë të përgjithshme.

Të drejtat e punës dhe sindikatave trajtohen në *Kapitullin 19 – Politika sociale dhe punësimi*.

Të drejtat e pronës

Kuadri ligjor dhe institucional për zbatimin e të drejtave të pronësisë është përgjithësisht i vendosur.

Megjithatë, gëzimi i plotë i të drejtave të pronësisë mbetet i kufizuar. Është arritur përparim i mëtijshëm në procesin e digjitalizimit, por deri më tani janë regjistruar vetëm 91% e tokave. Digjitalizimi është përfunduar vetëm për 43% të titujve të pronësisë, 69% të dokumenteve mbështetëse dhe 10% të hartave kadastrale. Rreth 80% e të dhënave të regjistruara më parë ende nuk janë verifikuar për saktësi. Vazhdojnë sfida të konsiderueshme, përfshirë korrupsionin e përhapur në ofrimin e shërbimeve, paqartësinë në pronësi, dhe mbivendosjen e kufijve të pronave si rezultat i ndërhyrjeve të pasakta dhe matjeve të gabuara gjatë dekadave të fundit. Shumë tituj pronësie dhe harta kadastrale vazhdojnë të ekzistojnë në format letre, ndërsa shumë transaksione pronësie kryhen ende duke përdorur dokumente të vjetra me të dhëna të pasakta, gjë që pengon sigurinë juridike dhe zhvillimin ekonomik. Në qershor 2025, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) miratoi një plan veprimi (roadmap) për përfundimin e plotë të digjitalizimit deri në dhjetor 2026 dhe të regjistrimeve fillestare të pronave të paluajtshme deri në dhjetor 2028. Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje, që pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2028, vazhdon; deri më tani, janë legalizuar rreth 64% e 400,000 aplikimeve, ndërsa 1% janë refuzuar.

Në dritën e shembjeve masive në shkallë kombëtare të ndërtimeve të dyshuara si të paligjshme, të ndërmarra nga autoritetet gjatë verës së vitit 2025, është thelbësore që proceset e legalizimit, shpronësimit dhe prishjes së ndërtesave të zhvillohen në përputhje të plotë me kuadrin ligjor ekzistues, përfshirë parimet e transparencës dhe të procesit të rregullt gjyqësor.

Në fund të vitit 2024, u krijua një grup pune për të hartuar një plan integriteti pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).

Kompensimet për pronat e konfiskuara gjatë periudhës komuniste kanë vazhduar, por me ritëm të ngadaltë. Më shumë se 26,000 kërkesa për kompensim janë pranuar nga Agjencia e Posaçme për Trajtimin e Pronës (ATP). ATP ka njohur të drejtën e pronësisë dhe vlerat e kompensimit në 19,000 raste, por ka ekzekutuar realisht vetëm rreth 800 prej tyre. Një problem madhor mbetet fakti që vetëm 10% e vlerës së pronës mund të kompensohet, ndërkohë që kjo vlerë vazhdon të bazohet në hartën e vlerësimit të qeverisë të vitit 2016, ku çmimet janë shpesh ndjeshëm më të ulëta se vlerat aktuale të tregut.

Mosdiskriminimi

Kuadri ligjor dhe institucional për mosdiskriminimin mbetet i paplotë dhe kapacitetet e institucioneve për barazinë kanë nevojë të forcohen.

Janë ndërmarrë pak hapa për të përafruar plotësisht kuadrin ligjor dhe institucional për mosdiskriminimin me acquis të BE-së, përfshirë Direktivën për Barazinë Racore, si dhe standardet evropiane për institucionet e barazisë. Në vitin 2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) vazhdoi të trajtonte një numër të qëndrueshëm rastesh, kryesisht në fushat e punësimit dhe të ofrimit të shërbimeve. Shqipëria duhet të zbatojë në mënyrë të qëndrueshme masat strategjike për luftën kundër diskriminimit dhe për forcimin e të drejtave të personave LGBTIQ dhe të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë planet sektoriale të veprimit për mosdiskriminim.

Shqetësime serioze vazhdojnë të ekzistojnë në lidhje me kuadrin institucional dhe ligjor për krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes. Legjislacioni mbi krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes duket se është në përputhje me acquis të BE-së dhe me standardet evropiane, megjithatë nevojiten kapacitete më të forta zbatimi dhe ndërgjegjësim më i gjerë, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta. Në vitin 2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) trajtoi dymbëdhjetë raste të gjuhës së urrejtjes, përfshirë ato mbi baza race, gjinie dhe orientimi seksual, dhe konfirmoi gjuhë urrejtjeje në dy prej rasteve. Nga janari deri në qershor 2025, KMD trajtoi njëmbëdhjetë raste të reja, të cilat janë ende në shqyrtim. Është e nevojshme të sigurohet trajnimi shtesë, rritja e ndërgjegjësisë dhe forcimi i kapaciteteve lidhur me krimet e urrejtjes për punonjësit e zbatimit të ligjit dhe profesionistët e drejtësisë. Mbledhja e të dhënave dhe statistikave mbi krimet e urrejtjes ende nuk është garantuar plotësisht.

Gjatë periudhës raportuese të vitit 2024, janë raportuar gjithsej shtatë raste të krimeve të urrejtjes në polici, ndërsa nga janari deri në qershor 2025 janë raportuar tetë raste.

Barazia gjinore

Kuadri ligjor dhe institucional për barazinë gjinore është pjesërisht i vendosur, por përafrimi i legjislacionit me acquis të BE-së, si dhe zbatimi dhe forcimi i tij, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Vazhdon të ketë dobësi në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe të Planit të saj të Veprimit. Gratë që jetojnë në zona rurale dhe të largëta, gratë rome dhe egjiptiane, si dhe personat LGBTIQ (lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë, interseks dhe kuir), vazhdojnë të përballen me forma të shumfishta diskriminimi. Aktivitetet për përgatitjen e Planeve Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore kanë vazhduar.

Kuadri ligjor për luftën kundër dhunës me bazë gjinore nuk është ende i përafruar me Konventën e Stambollit apo me acquis të BE-së. Dhuna ndaj grave dhe vajzave dhe dhuna në familje mbeten një shqetësim kritik, me nivel të lartë të mosraportimit për shkak të normave shoqërore dhe stigmës së lidhur me to. Sipas të dhënave, 47% e grave dhe vajzave raportojnë se kanë qenë viktimat e dhunës nga partneri intim. Zbatimi i dobët nga policia dhe mungesa e përgjegjshmërisë në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave mbeten çështje shqetësuese. Numri ende i lartë i vrasjeve të grave (femicideve) për frymë mbetet një shqetësim serioz. Shërbimet e specializuara të mbështetjes për viktimat e dhunës vazhdojnë të jenë të varura kryesisht nga donatorët dhe jo të mbështetura në mënyrë të qëndrueshme nga buxheti shtetëror. Ato mbeten të pamjaftueshme, veçanërisht në fushat e kujdesit shëndetësor, financimit të strehëzave, ndihmës juridike falas, si dhe riintegritit dhe rehabilitimit të viktimave të dhunës. Aktualisht janë në rishikim disa ligje kyçe, përfshirë, Ligjin për barazinë gjinore në shoqëri, Kodit Penal, në lidhje me krimet e femicidit, dhunës seksuale dhe dhunës kibernetike, dhe Kodit të Familjes, në lidhje me martesat e hershme (martesat e fëmijëve). Mbetet e rëndësishme që ndryshimet ligjore të jenë plotësisht të përafruara me acquis të BE-së dhe me standardet evropiane.

Të drejtat e fëmijëve

Kuadri ligjor dhe institucional për të drejtat e fëmijës është pjesërisht në fuqi, ndërsa zbatimi i tij kërkon përmirësim të mëtejshëm. Përpjekjet për zbatimin e masave në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duhet të jenë në përputhje me acquis të BE-së dhe të udhëhiqen nga rekomandimet kryesore të Komisionit Evropian, veçanërisht në lidhje me sistemet e integruara të mbrojtjes së fëmijëve.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës (AKDF) 2021–2026 përbën kuadrin strategjik kryesor të Shqipërisë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Vetëm 62% e masave të parashikuara në AKDF janë zbatuar plotësisht. Ligjet që synojnë mbrojtjen e të miturve nga martesa e hershme mbeten joefektive ose zbatohen në mënyrë të paqëndrueshme.

Shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve mbeten të pamjaftueshme, përfshirë edhe për fëmijët viktime të dhunës dhe dhunës në familje. Në vitin 2024, janë regjistruar 1,913 raste të fëmijëve viktime të dhunës. Dhuna dhe dhuna seksuale ndaj fëmijëve, përfshirë në mjedisin online, mbeten një fushë kritike shqetësimi. Numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve (241 në të 61 bashkitë) është shumë më i ulët se numri i nevojshëm për mbulimin efektiv. Në vitin 2024, 2,451 raste janë trajtuar nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, prej të cilave 1,386 ishin raste të reja, që kanë marrë shërbime sipas nivelit të riskut. Në vitin 2025, janë regjistruar 1,940 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, përfshirë 264 raste të reja të identifikuar. Është në zbatim një plan kombëtar për deinstitutionalizimin, i cili aktualisht po përditësohet, së bashku me hartimin e ligjit të ri për kujdesin alternativ dhe masat për forcimin e ofrimit të shërbimeve për fëmijët që kanë nevojë për kujdes familjar. Qasja në drejtësi për fëmijët pengohet nga vonesat procedurale, mungesa e ndihmës juridike dhe koordinimi i pamjaftueshëm institucional. Pavarësisht Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe Politikës për Përfshirje Sociale 2024–2028, 70% e fëmijëve mbeten në rrezik varfërie

Personat me aftësi të kufizuara

Kuadri ligjor dhe institucional për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është i paplotë, dhe zbatimi e forcimi i tij kanë ende nevojë për përmirësim të ndjeshëm. Legjislacioni kuadër i Shqipërisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është vetëm pjesërisht në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD), ndërkohë që Shqipëria nuk e ka ratifikuar ende Protokollin Opsional të UNCRPD-së, i cili parashikon mekanizmin e ankesave individuale. Janë ndërmarrë pak masa për të luftuar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara, për të përmirësuar aksesueshmërinë në përputhje me acquis të BE-së, përfshirë Aktin Evropian për Aksesueshmërinë, si dhe për të rritur mundësitë në punësim, arsim dhe pjesëmarrje në jetën politike dhe publike. Cilësia e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht për fëmijët me dëmtim të dëgjimit, vazhdon të jetë shqetësuese. Është bërë përparim i kufizuar në procesin e deinstitutionalizimit, i cili kërkon trajtim urgjent për të siguruar jetesë të pavarur dhe përfshirje të plotë shoqërore të personave me aftësi të kufizuara. Është vërejtur disa përparim në vlerësimin biopsikosocial, por ofrimi i shërbimeve duhet të forcohet më tej.

Personat LGBTIQ

Mbrojtja ligjore e të drejtave të personave LGBTIQ ka nevojë të përmirësohet dhe të përafrrohet më tej me acquis të BE-së. Përveç kësaj, personat LGBTIQ përballen me nivele të larta diskriminimi, ndërkohë që mungon mbledhja gjithëpërfshirëse e të dhënave që do të mundësonte vlerësimin e plotë të situatës së tyre.

Kuadri ligjor dhe institucional për të drejtat e personave LGBTIQ është i paplotë dhe duhet të përafrrohet më tej me acquis të BE-së dhe me standardet evropiane. Shqipëria ende nuk ka legjislacion që njeh bashkëjetesën civile, martesën midis personave të të njëjtit seks, prindërimin nga çiftet të të njëjtit seks, apo njohjen ligjore të identitetit gjinor. Protokollin mjekësor për personat transgjinorë dhe me identitete gjinore të ndryshme nuk është miratuar ende. Shumica e masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimeve për Personat LGBTIQ 2021–2027 nuk janë zbatuar, për shkak të mungesës së burimeve dhe mungesës së vullnetit politik. Diskriminimi ndaj personave LGBTIQ mbetet i përhapur. Parada “Tirana Pride” u zhvillua në mënyrë paqësore më 24 maj 2025.

Të drejtat procedurale dhe të drejtat e viktimave

Kuadri ligjor për të drejtat procedurale të personave të dyshuar dhe të akuzuar, si dhe për të drejtat e viktimave të krimit, është pjesërisht i përafruar me acquis të BE-së.

Kuadri ligjor për ndihmën juridike është i plotë, dhe ndihma juridike parësore dhe dytësore ofrohet si në nivelin qendror ashtu edhe në atë vendor. Megjithatë, tarifatat për çështjet e ndihmës juridike mbeten të pamjaftueshme për të tërhequr përfaqësim juridik me cilësi të lartë. Masat për lehtësimin e aksesit në drejtësi për grupet më

të cënueshme, në kuadër të hartës së re gjyqësore, nuk janë vendosur ende. Vazhdojnë mangësitë lidhur me buxhetin dhe koordinimin e pamjaftueshëm për mbrojtjen e viktimave të krimit. Nuk është arritur asnjë përparim në krahasim me raportin e vitit 2024 në adresimin e çështjeve të mbetura që lidhen me të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe të akuzuarve, përfshirë elementet që kanë të bëjnë me të drejtën për informacion në procedurat penale, aksesin të një avokat dhe parimin e prezumimit të pafajësisë. Buxheti për mbështetjen, mbrojtjen dhe kompensimin e viktimave mbetet kryesisht i pamjaftueshëm dhe duhet të rritet më tej.

Mbrojtja e pakicave

Kuadri ligjor dhe institucional për mbrojtjen e personave që u përkasin pakicave ka nevojë të përmirësohet dhe të përafrrohet më tej me *acquis* të BE-së.

Personat që u përkasin pakicave vazhdojnë të përballen me forma diskriminimi. Një arritje e rëndësishme është miratimi i tre akteve nënligjore zbatuese në dhjetor 2024, të cilat ishin të domosdoshme për zbatimin e kuadrit ligjor përkatës.

Këto akte trajtojnë çështje thelbësore që lidhen me vetëidentifikimin e lirë dhe përdorimin e gjuhëve nga personat që u përkasin pakicave, duke siguruar përafrim me standardet evropiane dhe me parimin e vetëidentifikimit të lirë.

Shqipëria duhet ende të sigurojë zbatimin efektiv të kuadrit ligjor, veçanërisht përmes alokimit të burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për agjencitë qendrore dhe qeverisjen vendore, si dhe përmes pajisjes dhe trajnimit të autoriteteve lokale, përfshirë në mbledhjen e të dhënave, bazuar në projeksione vjetore. Gjithashtu, Shqipëria duhet të garantojë që Komiteti Shtetëror për Pakicat Kombëtare të ketë burime të mjaftueshme dhe që procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të tij të rishikohen në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe të Komitetit Këshillimor të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Romët

Kuadri ligjor dhe institucional për Romët duhet të përmirësohet më tej, ndërkohë që Romët vazhdojnë të përballen me diskriminim. Norma e përgjithshme e punësimit për Romët dhe Egjiptianët mbetet shumë e ulët. Ndërsa aksesimi i shërbimeve bazë të kujdesit shëndetësor publik është i garantuar, aksesimi i shërbimeve shtesë që kërkojnë pagesë mbetet i kufizuar për arsye financiare për të dy komunitetet vulnerabël. Kostoja e regjistrimit civil vazhdon të jetë sfiduese në rastet kur kërkohet testim i ADN-së. Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri (2021–2025) dhe i angazhimeve të Poznanit duhet të përmirësohet ndjeshëm. Kapacitetet institucionale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë mbetur të dobëta gjatë gjithë periudhës së raportimit.

Megjithatë, emërimi i një Zëvendësministri të ri me përgjegjësi të posaçme për grupet vulnerabël, përfshirë Romët dhe Egjiptianët, përbën një zhvillim pozitiv. Nevojiten përpjekje dhe burime shtesë për të përshpejtuar përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve, për të luftuar anti-ciganizmin, diskriminimin dhe ndarjet arsimore e fizike, për të nxitur pjesëmarrjen e Romëve dhe për të reduktuar hendekun me pjesën tjetër të popullsisë.

Të drejtat që rrjedhin nga shtetësia

Shqipëria duhet të përshtasë kuadrin e saj ligjor me *acquis* të BE-së mbi të drejtat e qytetarisë së BE-së, me synimin për një përafrim të plotë përpara anëtarësimit.

Kjo duhet të përfshijë kryerjen e një analize të plotë mbi nevojat e përafrimit dhe zbatimit që burojnë nga Direktiva e BE-së për të drejtën e qytetarëve të Unionit për t'u lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm në Shtetet

Anëtare, në të gjitha fushat e politikave të prekura, si dhe planifikimin në kohë të përafrimit përkatës. Për të siguruar përputhshmëri të plotë me të drejtën e BE-së, Shqipëria do të duhet të shfuqizojë bazën ligjore që lejon zhvillimin e një skeme për dhënien e shtetësisë për investitorët, pasi të tilla skema bien ndesh me të drejtën e BE-së dhe përbëjnë rreziqe në lidhje me sigurinë, pastrimin e parave, evazionin fiskal, financimin e terrorizmit, korrupsionin dhe infiltrimin nga krimi i organizuar.